



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

---

## **PROJEKTLIGJI PËR AKTET JURIDIKE<sup>1</sup>**

## **DRAFT LAW ON LEGAL ACTS<sup>2</sup>**

## **NACRT ZAKONA O PRAVNIM AKTIMA<sup>3</sup>**

---

<sup>1</sup> Projektligji për aktet juridike, është miratuar në mbledhjen e 16 të Qeverisë së Kosoves, me Vendimin nr. 02/16, date 01.12.2017.

<sup>2</sup> Draft law on legal acts, was approved on the 16 meeting of the Government of Kosovo, with the decision no. 02/16, 01.12.2017.

<sup>3</sup> Nacrt zakona o pravnim aktima, usvojen je na 16 sednicu Vlade Kosova, sa odlukom br. 02/16, datum 01.12.2017.

Kuvendi i Republikës së Kosovës,  Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,  Miraton:  <b>LIGJ PËR AKTET JURIDIKE</b>  <b>KAPITULLI I</b> <b>DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b>	Assembly of the Republic of Kosovo,  Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,  Adopts:  <b>LAW ON LEGAL ACTS</b>  <b>CHAPTER I</b> <b>GENREAL PROVISIONS</b>	Skupština Republike Kosovo,  U skladu sa članom 65.1 Ustava Republike Kosovo,  Donosi:  <b>ZAKON O PRAVNIM AKTIMA</b>  <b>POGLAVLJE I</b> <b>OPŠTE ODREDBE</b>
<b>Neni 1</b> <b>Qëllimi</b>  Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i llojeve dhe hierarkisë së akteve juridike, si dhe përcaktimi i parimeve dhe standardeve për hartimin, nxjerrjen, miratimin, konsolidimin, korigjimin dhe publikimin e akteve juridike.	<b>Article1</b> <b>Purpose</b>  This law shall aim to define the types and hierarchy of legal acts, as well as the definition of principles and standards for drafting, issuing, approving, consolidating, correcting and publishing legal acts.	<b>Član 1</b> <b>Svrha</b>  Svrha ovog Zakona je određivanje vrste i hijerarhije propisa, kao i određivanje načela i standarda za izradu, donošenje, usvajanje, konsolidaciju, ispravku i objavljinje pravnih akata.
<b>Neni 2</b> <b>Fushëveprimi</b>  1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjitha institucionet publike të nivelit qendror dhe lokal të Republikës së Kosovës, që janë autoritete kompetente, për të hartuar, nxjerr, miratuar, dhe publikuar akte juridike sipas Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi.	<b>Article 2</b> <b>Scope</b>  1. Provisions of this law shall apply to all central level public institutions of the Republic of Kosovo, that are competent authorities to draft, issue, approve and publish legal acts under the Constitution and applicable laws.	<b>Član 2</b> <b>Delokrug</b>  1. Odredbe ovog Zakona se primenjuju na sve javne institucije centralnog i lokalnog nivoa Republike Kosovo, koje su organi nadležni za izradu, donošenje, usvajanje, prečišćavanje, ispravljanje i objavljinje pravnih akata prema Ustavu i zakonima na snazi.

<p>2. Akte juridike, në kuptim të këtij ligji, nuk janë aktet e përcaktuara me Ligjin përkatës për procedurën administrative.</p>	<p>2. Legal acts, in terms of this law, are not acts as defined by the relevant Law on Administrative Procedure.</p>	<p>2. Pravni akti, u smislu ovog Zakona, nisu akti koji su propisani odgovarajućim Zakonom o upravnom postupku.</p>
<p><b>Neni 3</b> <b>Përkufizimet</b></p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:</p> <p>1.1. <b>Akt juridik</b> - nënkupton rregullat e përgjithshme të sjelljes për një marrëdhënie juridike ose për një kompleks marrëdhëniesh, që zbatohen për një numër të pacaktuar, të pakufizuar të individëve përfusha të caktuara dhe kanë veprim të shumëfishtë që nxirren dhe miratohen nga autoriteti kompetent;</p> <p>1.2. <b>Dekret</b> - nënkupton aktin juridik që nxirret nga Presidenti apo Kryeministri, në kuadër të autorizimeve të dhëna në bazë të Kushtetutës dhe ligjit;</p> <p>1.3. <b>Vendim</b> - nënkupton aktin juridik që nxirret nga autoriteti kompetent dhe në kuadër të autorizimeve të dhëna në bazë të ligjit dhe / apo aktit nënligjor me të cilat vendoset përfshirje, përfshirje cilat kërkohet një vendim përkatës;</p>	<p><b>Article 3</b> <b>Definitions</b></p> <p>1. The terms used in this law shall have the following meaning:</p> <p>1.1. <b>Legal act</b> – shall mean the general rules of conduct related to a legal relationship or a complex relationship that apply to an indefinite, unlimited number of individuals for certain areas and act in a multiple manner, and adopted or issued by the competent authority;</p> <p>1.2. <b>Decree</b> – shall mean a legal act issued by the President or the Prime Minister, within the powers granted under the Constitution and the law;</p> <p>1.3. <b>Decision</b> – shall mean a legal act issued by the competent authority within the authority granted under the law and/or sub-legal act by means of which is decided on matters for which a relevant decision is required;</p>	<p><b>Član 3</b> <b>Definicije</b></p> <p>1. Izrazi korišćeni u ovom Zakonu imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. <b>Pravni akt</b> - znači opšta pravila ponašanja u jednom pravnom odnosu ili nizu odnosa, koja se odnose na neodređen, neograničen broj pojedinaca za određene oblasti i imaju mnogostruki uticaj, a koja donosi i usvaja nadležni organ;</p> <p>1.2. <b>Dekret</b> - znači pravni akt koji donosi predsednik ili premijer, u okviru ovlašćenja datih na osnovu Ustava ili zakona;</p> <p>1.3. <b>Odluka</b> - znači pravni akt koji donosi nadležni organ i u okviru nadležnosti propisanih ovlašćenja na osnovu zakona i/ili podzakonskog akta kojim se odlučuje o pitanjima za koja je potrebno donošenje odgovarajućeg akta;</p>

<p><b>1.4 Akt nënligjor-</b> nënkuption aktin juridik i cili nxirret nga autoriteti kompetent, për zbatim të ligjit dhe mbi bazën e autorizimit ligjor;</p> <p><b>1.5. Udhëzim administrativ</b> - nënkuption aktin juridik i cili nxirret nga autoriteti kompetent, për zbatim të ligjit, në bazë të autorizimit ligjor dhe në përputhje me qëllimin dhe synimet e ligjit përkatës, si dhe për rregullimin në detaje të çështjeve që rregullohen nga ligji përkatës;</p> <p><b>1.6. Rregullore</b> - nënkuption aktin juridik i cili nxirret nga autoriteti kompetent, për zbatim të ligjit, në bazë të autorizimit ligjor dhe në përputhje me qëllimin dhe synimet e ligjit përkatës e që ka të bëjë me rregullimin e funksionimit administrativ, organizimin e brendshëm, proceset e vendimmarrjes, sistematizimin, mënyrën dhe procedurat e punës përfshirë çështjet e tjera organizative dhe të fushëveprimit që nxirren në kuadër të autorizimeve të dhëna në bazë të Kushtetutës dhe ligjit;</p> <p><b>1.7. Urdhër</b> – nënkuption aktin juridik të brendshëm me karakter detyrues, i cili nxirret në bazë të ligjit apo aktit nënligjor dhe i cili i drejtohet një numri të caktuar të personave apo subjekteve të caktuara;</p>	<p><b>1.4 Sub-legal act</b> – shall mean a legal act issued by the competent authority for implementation of a law and under the authority granted by law;</p> <p><b>1.5. Administrative Instruction</b> – shall mean a legal act issued by the competent authority for law implementation, under the authority granted by law and in accordance with the purpose and goals of the relevant law, and in order to regulate in detail matters governed by the relevant law;</p> <p><b>1.6. Regulation</b> – shall mean a legal act issued by the competent authority for law implementation, under the authority granted by law and in accordance with the purpose and goals of the relevant law, addressing the governance of administrative functioning, internal organization, decision-making processes, systematization, manner and procedures of work, including other organizational and scope matters issued under the authority granted by the Constitution and law;</p> <p><b>1.7. Order</b> – shall mean an internal legal act of binding nature issued on the basis of a law or sub-legal act and which addresses to a certain number of particular persons or entities;</p>	<p><b>1.4. Podzakonski akt</b> - znači pravni akt koji donosi organ nadležan za sprovođenje zakona na osnovu zakonskih ovlašćenja;</p> <p><b>1.5. Administrativno uputstvo</b> - znači pravni akt koji donosi nadležni organ za sprovođenje zakona na osnovu zakonskih ovlašćenja i u skladu sa svrhom i ciljevima odgovarajućeg zakona, kao i za detaljno uređenje pitanja koja uređuje navedeni zakon;</p> <p><b>1.6. Uredba</b> - znači pravni akt koji donosi nadležni organ za sprovođenje zakona na osnovu zakonskih ovlašćenja i u skladu sa svrhom i ciljevima odgovarajućeg zakona, a koji se odnosi na uređenje administrativnih funkcija, internu organizaciju, postupak donošenja odluka, sistematizaciju, način i postupak rada, uključujući druga organizaciona i pitanja delokruga koja se donose u okviru ovlašćenja datih na osnovu Ustava i zakona;</p> <p><b>1.7. Naredenje</b> - podrazumeva interni pravni akt obavezujućeg karaktera, koji se donosi na osnovu zakona ili podzakonskog akta i koji je adresiran određenom broju osoba ili određenim subjektima;</p>
---	--	---

<p>1.8. <b>Urdhëresa</b> – nënkuption aktin juridik i cili nxirret nga autoriteti kompetent, për zbatim të ligjit, në bazë të autorizimit ligjor e cila nxirret për afat të caktuar dhe për një çështje specifike;</p> <p>1.9. <b>Akti juridik i Institucioneve të Pavarura</b> – nënkuption aktin juridik i cili nxirret nga institucionet e pavarura për zbatim të ligjit dhe sipas autorizimit të dhënë me Kushtetutë dhe / apo me ligj;</p> <p>1.10. <b>Akti juridik i organeve komunale</b> – nënkuption aktin juridik i cili nxirret në bazë të autorizimit dhe kompetencave të përcaktuara në ligjin përkatës për vetëqeverisjen lokale dhe / apo me ligje të tjera, si dhe zbatohet brenda territorit të komunës përkatëse.</p> <p><b>KAPITULLI II</b> <b>PARIMET E HARTIMIT TË AKTEVE JURIDIKE</b></p> <p><b>Neni 4</b> <b>Parimet e hartimit të aktit juridik</b></p> <p>1. Hartimi i aktit juridik i nënshtrohet parimeve në vijim:</p>	<p>1.8. <b>Directive</b> – shall mean a legal act issued by the competent authority for law implementation, under legal authority issued for a fixed term and for a specific matter;</p> <p>1.9. <b>Legal Act of Independent Institutions</b> – shall mean a legal act issued by independent institutions for law implementation and under the authority granted under the Constitution and/or by law;</p> <p>1.10. <b>Legal Act of Municipal Bodies</b> – shall mean a legal act issued under the authority and powers defined in the relevant Law on Local Self-Government and/or other laws and is implemented within the territory of relevant municipality.</p> <p><b>CHAPTER II</b> <b>PRINCIPLES OF DRAFTING LEGAL ACTS</b></p> <p><b>Article 4</b> <b>Principles of drafting legal acts</b></p> <p>1. Drafting a legal act is subject to the following principles:</p>	<p>1.8. <b>Nalog</b> - znači pravni akt koji donosi nadležni organ za sprovođenje zakona na osnovu zakonskih ovlašćenja i koji se donosi na određeni rok i za određeno pitanje;</p> <p>1.9. <b>Pravni akt nezavisne institucije</b> - znači pravni akt koji donose nezavisne institucije za sprovođenje zakona i prema ovlašćenjima datim na osnovu Ustava ili zakona;</p> <p>1.10. <b>Pravni akt opštinskih organa</b> - znači pravni akt koji se donosi na osnovu ovlašćenja i nadležnosti propisanih u odgovarajućem zakonu o lokalnoj samoupravi i/ili drugim zakonima, a sprovodi se na teritoriji odgovarajuće opštine.</p> <p><b>POGLAVLJE II</b> <b>NAČELA IZRADE PRAVNIH AKATA</b></p> <p><b>Član 4</b> <b>Načela izrade pravnog akta</b></p> <p>1. Izrada pravnog akta je podložno sledećim načelima:</p>
--	--	---

<p><b>1.1. Kushtetutshmëria:</b> ligjet dhe të gjitha aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën;</p> <p><b>1.2. Ligjshmëria:</b> aktet nënligjore nxirren në bazë të autorizimit të përcaktuar shprehimisht me ligj dhe duhet të jenë në pajtim me ligjin;</p> <p><b>1.3. Transparency:</b> aktet juridike hartohen në mënyrë të hapur, gjithëpërfshirëse dhe njëkohësisht adresojnë komentet dhe sugjerimet nga publiku dhe palët e interesuara si dhe duhet të publikohen në pajtim me këtë ligj dhe ligjin përkatës për gazeten zyrtare;</p> <p><b>1.4. Proporcionaliteti:</b> aktet juridike nuk tejkalojnë kërkesat dhe fushëveprimin për të adresuar çështjen ose problemin të cilin akti juridik ka për qëllim ta rregullojë;</p> <p><b>1.5. Domosdoshmëria:</b> akti juridik duhet të jetë i kërkuar nga një rrëthanë mbizotëruese ose për të bërë të detyrueshëm një veprim për realizimin e një objekti të ligjshëm;</p> <p><b>1.6. Përputhshmëria:</b> dispozitat e aktit juridik në tërësi duhet të jenë në ndërlidhje logjike dhe në përputhshmëri me njëra tjetrën;</p>	<p><b>1.1. Constitutionality:</b> laws and all other legal acts must be in accordance with the Constitution;</p> <p><b>1.2. Legality:</b> sub-legal acts are issued under the authority explicitly granted by law and must be in accordance with the law;</p> <p><b>1.3. Transparency:</b> legal acts are drafted in an open and inclusive manner and at the same time address comments and suggestions from the public and stakeholders, and must be published pursuant to this law and the relevant Law on Official Gazette;</p> <p><b>1.4. Proportionality:</b> legal acts shall not exceed its requirements and scope to address the matter or issue that a legal act intends to govern;</p> <p><b>1.5. Necessity:</b> a legal act shall be required by prevailing circumstances or to compel a certain course of action in furtherance of a lawful objective;</p> <p><b>1.6. Compatibility:</b> provisions of a legal act, in their entirety, must be logically interlinked and in accordance with each other;</p>	<p><b>1.1. Ustavnost:</b> zakoni i svi drugi pravni akti trebaju da budu u skladu sa Ustavom;</p> <p><b>1.2. Zakonitost:</b> podzakonski akti se donose na osnovu ovlašćenja izričito propisanih u zakonu i trebaju da budu u skladu sa zakonom;</p> <p><b>1.3. Transparentnost:</b> pravni akti se izrađuju na otvoren, sveobuhvatan način i istovremeno odgovaraju na komentare i sugestije javnosti i zainteresovanih strana, a takođe se trebaju objaviti u skladu sa ovim zakonom i odgovarajućim zakonom o službenom listu;</p> <p><b>1.4. Proporcionalnost:</b> pravni akti ne prevazilaze zahteve i delokrug za adresiranje pitanja ili problema koji pravni akt ima za cilj da uredi;</p> <p><b>1.5. Neophodnost:</b> pravni akt treba da bude zahtevan prevladavajućom okolnošću ili kako bi se određena radnja za realizaciju određenog zakonitog cilja učinila obaveznom;</p> <p><b>1.6. Usaglašenost:</b> odredbe pravnog akta trebaju da budu u logičkoj vezi i usaglašene jedna sa drugom;</p>
---	---	---

<p><b>1.7. Standardizimi:</b> akti juridik hartohet në bazë të standardeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për hartimin e akteve juridike.</p> <p><b>Neni 5</b> <b>Ndërlidhja ndërmjet akteve juridike</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet tjera juridike duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe aktet tjera juridike të një niveli më të lartë.</li> <li>2. Ligjet dhe aktet tjera juridike të Republikës së Kosovës interpretohen në pajtueshmëri me Kushtetutën. Në rast të papajtueshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera juridike dhe dispozitave të Kushtetutës, dispozitat kushtetuese mbizotërojnë.</li> <li>3. Nëse një ligj apo një akt tjetër juridik i Republikës së Kosovës është në kundërshtim me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, siç përcaktohet në Nenin 6 të këtij ligji, atëherë normat e vendosura nga këto marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare mbizotërojnë.</li> <li>4. Nëse një akt juridik i nivelit më të ulët është në kundërshtim me një akt juridik të nivelit më</li> </ol>	<p><b>1.7. Standardization:</b> a legal act is drafted pursuant to standards defined under the applicable legislation on drafting legal acts.</p> <p><b>Article 5</b> <b>Interconnectivity between legal acts</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. The Constitution is the highest legal act of the Republic of Kosovo. Laws and other legal acts must be in accordance with the Constitution and other legal acts of a higher level.</li> <li>2. Laws and other legal acts of the Republic of Kosovo shall be interpreted in accordance with the Constitution. In case there are inconsistencies of laws and other legal acts and provisions of the Constitution, the Constitution shall always prevail.</li> <li>3. If a law or other legal act of the Republic of Kosovo is in contradiction with international agreements and instruments, as defined in Article 6 of this law, than the norms set forth by these international agreements and instruments shall prevail.</li> <li>4. If a lower-level legal act is in contradiction with a higher-level legal act, the legal act of</li> </ol>	<p><b>1.7. Standardizacija:</b> pravni akt se izrađuje na osnovu standarda propisanih zakonodavstvom na snazi o izradi pravnih akata.</p> <p><b>Član 5</b> <b>Povezanost između pravnih akata</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ustav je najviši pravni akt Republike Kosovo. Zakoni i drugi pravni akti trebaju da budu u skladu sa Ustavom i drugim pravnim aktima višeg nivoa.</li> <li>2. Zakoni i drugi pravni akti Republike Kosovo se tumače u skladu sa Ustavom. U slučaju nesaglasnosti zakona i drugih pravnih akata i odredbi Ustava, ustavne odredbe prevladavaju.</li> <li>3. Ako je određeni zakon ili drugi pravni akt Republike Kosovo u suprotnosti sa međunarodnim sporazumima i instrumentima, kao što je propisano članom 6. ovog Zakona, onda prevladavaju norme propisane tim međunarodnim sporazumima i instrumentima.</li> <li>4. Ako je određeni pravni akt nižeg nivoa u suprotnosti sa pravnim aktom višeg nivoa,</li> </ol>
<p><b>1.7. Standardizimi:</b> akti juridik hartohet në bazë të standardeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për hartimin e akteve juridike.</p> <p><b>Neni 5</b> <b>Ndërlidhja ndërmjet akteve juridike</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet tjera juridike duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe aktet tjera juridike të një niveli më të lartë.</li> <li>2. Ligjet dhe aktet tjera juridike të Republikës së Kosovës interpretohen në pajtueshmëri me Kushtetutën. Në rast të papajtueshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera juridike dhe dispozitave të Kushtetutës, dispozitat kushtetuese mbizotërojnë.</li> <li>3. Nëse një ligj apo një akt tjetër juridik i Republikës së Kosovës është në kundërshtim me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, siç përcaktohet në Nenin 6 të këtij ligji, atëherë normat e vendosura nga këto marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare mbizotërojnë.</li> <li>4. Nëse një akt juridik i nivelit më të ulët është në kundërshtim me një akt juridik të nivelit më</li> </ol>	<p><b>1.7. Standardization:</b> a legal act is drafted pursuant to standards defined under the applicable legislation on drafting legal acts.</p> <p><b>Article 5</b> <b>Interconnectivity between legal acts</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. The Constitution is the highest legal act of the Republic of Kosovo. Laws and other legal acts must be in accordance with the Constitution and other legal acts of a higher level.</li> <li>2. Laws and other legal acts of the Republic of Kosovo shall be interpreted in accordance with the Constitution. In case there are inconsistencies of laws and other legal acts and provisions of the Constitution, the Constitution shall always prevail.</li> <li>3. If a law or other legal act of the Republic of Kosovo is in contradiction with international agreements and instruments, as defined in Article 6 of this law, than the norms set forth by these international agreements and instruments shall prevail.</li> <li>4. If a lower-level legal act is in contradiction with a higher-level legal act, the legal act of</li> </ol>	<p><b>1.7. Standardizacija:</b> pravni akt se izrađuje na osnovu standarda propisanih zakonodavstvom na snazi o izradi pravnih akata.</p> <p><b>Član 5</b> <b>Povezanost između pravnih akata</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ustav je najviši pravni akt Republike Kosovo. Zakoni i drugi pravni akti trebaju da budu u skladu sa Ustavom i drugim pravnim aktima višeg nivoa.</li> <li>2. Zakoni i drugi pravni akti Republike Kosovo se tumače u skladu sa Ustavom. U slučaju nesaglasnosti zakona i drugih pravnih akata i odredbi Ustava, ustavne odredbe prevladavaju.</li> <li>3. Ako je određeni zakon ili drugi pravni akt Republike Kosovo u suprotnosti sa međunarodnim sporazumima i instrumentima, kao što je propisano članom 6. ovog Zakona, onda prevladavaju norme propisane tim međunarodnim sporazumima i instrumentima.</li> <li>4. Ako je određeni pravni akt nižeg nivoa u suprotnosti sa pravnim aktom višeg nivoa,</li> </ol>

<p>të lartë, mbizotëron akti juridik i nivelit më të lartë.</p>	<p>the higher level shall prevail.</p>	<p>prevladava pravni akt višeg nivoa.</p>
<p>5. Nëse një akt juridik i natyrës së përgjithshme dhe një akt juridik i natyrës së veçantë i nivelit të njëjtë rregullojnë ndryshe të njëjtën çështje, atëherë mbizotërojnë normat e aktit juridik të natyrës së veçantë.</p>	<p>5. If a legal act of a general nature and a legal act of a special nature of the same level governs differently the same matter, the norms of the legal act of a special nature shall prevail.</p>	<p>5. Ako jedan opšti pravni akt i jedan poseban pravni akt istog nivoa na različite načine uređuju isto pitanje, onda prevladavaju norme posebnog pravnog akta.</p>
<p>6. Nëse një akt juridik i nivelit të njëjtë është në kundërshtim me një akt juridik të nivelit të njëjtë dhe që të dy aktet juridike janë të natyrës së përgjithshme apo të natyrës së veçantë, mbizotëron akti juridik i cili është nxjerrë më vonë.</p>	<p>6. If a legal act is in contradiction to a legal act of the same level and both legal acts are of a general nature or of a special nature, the most recently issued legal act shall prevail.</p>	<p>6. Ako je jedan pravni akt istog nivoa u suprotnosti sa pravnim aktom istog nivoa i oba su pravna akta opšte ili posebne prirode, prevladava pravni akt koji je donet kasnije.</p>
<p>7. Ndërlidhja ndërmjet akteve juridike, të cilat kanë nivele të ndryshme, duhet të përcaktohet në bazë të autoritetit nxjerrës, në hierarkinë e organeve të pushtetit shtetëror siç përcaktohet në Nenin 6 të këtij ligji.</p>	<p>7. Interconnectivity between legal acts of different levels shall be determined based on the issuing authority in the hierarchy of the state government bodies, as defined in Article 6 of this law.</p>	<p>7. Povezanost između pravnih akata koji su raznih nivoa treba odrediti na osnovu organa donosioca u hijerarhiji organa državne vlasti kao što je propisano članom 6. ovog Zakona.</p>
<p>8. Nëse një autoritet jo kompetent nxjerrë një akt juridik, ai akt juridik nuk do të këtë fuqi juridike dhe anulohet nga autoriteti kompetent për nxjerrjen e tij apo nga autoriteti kompetent më i lartë.</p>	<p>8. If an incompetent authority issues a legal act, that legal act shall not have legal effect and shall be revoked by the authority competent for its issuance or by the highest competent authority.</p>	<p>8. Ako jedan nenadležan organ doneše određeni pravni akt, takav pravni akt nema pravnu moć i poništava ga organ nadležan za donošenje istog ili viši nadležni organ.</p>
<p>9. Nxjerra e aktit juridik që ndërlidhet me fushëveprimin dhe përgjegjësitë e dy apo më shumë institucioneve miratohet nga autoriteti më i lartë.</p>	<p>9. Issuance of a legal act interconnected with the scope and responsibilities of two or more institutions shall be adopted by the highest competent authority.</p>	<p>9. Pravni akt koji je povezan sa delokrugom i odgovornostima dve ili više institucija donosi viši organ.</p>

<p>10. Nëse një akt juridik është nxjerr nga një autoritet kompetent që pushon së ekzistuari ose që është bashkuar me një autoritet tjetër kompetent, ky akt juridik do të mbesë në fuqi dhe do të zbatohet nga autoriteti kompetent pasardhës.</p>	<p>10. If a legal act is issued by a competent authority that ceases to exist or has been merged with another competent authority, such legal act shall remain in force and shall be enforced by the successor competent authority.</p>	<p>10. Ako je pravni akt doneo organ koji je prestao sa postojanjem ili je ujedinjen sa drugim nadležnim organom, takav pravni akt ostaje na snazi i sprovodi ga nadležan nasledni organ.</p>
<p><b>KAPITULLI III</b> <b>LLOJET DHE HIERARKIA E AKTEVE JURIDIKE</b></p> <p><b>Neni 6</b> <b>Llojet dhe hierarkia e akteve juridike</b></p> <p>1. Llojet dhe hierarkia e akteve juridike është si në vijim:</p> <p>1.1. Kushtetuta, përfshirë amendamentet e saj;</p> <p>1.2. Marrëveshjet ndërkombëtare:</p> <p>1.2.1. Marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare që zbatohen drejtëpërdrejt në Republikën e Kosovës në bazë të nenit 22 të Kushtetutës;</p> <p>1.2.2. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në bazë të Kushtetutës nga</p>	<p><b>CHAPTER III</b> <b>TYPES AND HIERARCHY OF LEGAL ACTS</b></p> <p><b>Article 6</b> <b>Types and hierarchy of legal acts</b></p> <p>1. Types and hierarchy of legal acts are as follows:</p> <p>1.1. Constitution, including its amendments;</p> <p>1.2. International agreements:</p> <p>1.2.1. International agreements and instruments directly applicable in the Republic of Kosovo under Article 22 of the Constitution;</p> <p>1.2.2. International agreements ratified by the Assembly or the</p>	<p><b>POGLAVLJE III</b> <b>VRSTA I HIJERARHIJA PRAVNIH AKATA</b></p> <p><b>Član 6</b> <b>Vrsta i hijerarhija pravnih akata</b></p> <p>1. Vrsta i hijerarhija pravnih akata je sledeća:</p> <p>1.1. Ustav, uključujući amandmane istog;</p> <p>1.2. Međunarodni sporazumi:</p> <p>1.2.1. Međunarodni sporazumi i instrumenti koji su direktno primenjivi u Republici Kosovo na osnovu člana 22. Ustava,</p> <p>1.2.2. Međunarodni sporazumi ratifikovani na osnovu Ustava u</p>

<p>Kuvendi apo Presidenti dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombe. </p>	<p>President, pursuant to the Constitution, and the legally binding norms of international law.</p>	<p>Skupštini ili od strane predsednika i pravno obavezujuće norme međunarodnog prava;</p>
<p>1.3. Ligjet përfshirë ligjet me interes vital, ligjet që miratohen me votat e shumcës së deputetve të Kuvendit dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë, ligjet që miratohen me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve dhe ligjet që miratohen me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë.</p>	<p>1.3. Laws including the laws of vital interest, the laws adopted by the majority of votes of the Assembly Members and by the majority of votes of Assembly Members with guaranteed seats for representatives of non-majority communities, laws adopted by two-thirds (2/3) of the votes of all Assembly Members, and laws adopted by a majority of the votes of the present and voting Assembly Members.</p>	<p>1.3. Zakoni uključujući zakone od vitalnog interesa, zakoni koji se usvajaju većinom glasova skupštinskih poslanika i većine skupštinskih poslanika koji drže zagarantovana mesta za predstavnike nevećinskih zajednica, zakoni koji se usvajaju glasovima dve trećine (2/3) svih poslanika i zakoni koji se usvajaju većinom prisutnih poslanika i koji glasaju;</p>
